

VENDIM
Nr.429, datë 2.7.2004

**PËR KALIMIN E PORTIT TË PESHKIMIT, SHËNGJIN NË ADMINISTRIM TË
NDËRMARRJES SË RITJES SË MIDHJEVE SARANDË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Porti i peshkimit, Shëngjin, së bashku me infrastrukturën përkatëse, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, t’i kalojë në administrim ndërmarrjes së rritjes së midhjes, Sarandë.
 2. Për ndërmarrjen e rritjes së midhjeve, Sarandë të ruhet pronësia shtetërore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

